

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:11

RENDI I DITËS

*Projekt vendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Lëvizja për Ndryshim
Për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill
2021”.*

PJESËMARRJA :

- KQZ
- Ilirjan Celibashi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Staf i KQZ Z.Y.Merkaj, Z.E.Jorgaqi, Z.O.Peto

Z.I.Celibashi: Mirë, fillojmë seancën publike të zhvilluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, seancë e cila ka në rendin e ditës për shqyrtim çështjet si vijojnë:

1. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Lëvizja për Ndryshim për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
2. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Lëvizja Demokratike Shqipëtare për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
3. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Ora e Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
4. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike Shqipëtare për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
5. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Bindja Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

6. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Lëvizja e Legalitetit për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
 7. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
 8. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Balli Kombëtarë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
 9. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Emigracioni Shqipëtarë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
 10. “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Reforma Demokratike e shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
 11. “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Komitetit Nismëtarë që do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Pal Shkëmbi si kandidat I propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore qarku Shkodër, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
 12. “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Komitetit Nismëtarë që do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Plarent Aleksi si kandidat I propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore qarku Berat, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”
- Dhe pika e fundit e rendit të ditës ka të bëjë me
13. “Caktimi qendrave të votimit, ndërtesave private për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”

Z.Y.Merkaj: Jo zoti Komisioner, pika e fundit nuk është. Është dërguar për njohje Partie Politike, se kemi si pikë renditje.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

Z.I.Celibashi: Dakort. Fillojmë me pikën e parë, një relativitet shkurt nga ana e sekretarit të KQZ- së për secilën prej kërkesave për rregjistrim si subjekte zgjedhore.

Z.Y.Merkaj: Me dekretin nr 11700 datë 06.09.2020 të Presidentit të Republikës ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar nenit 61 pika 1 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për tu rregjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Gjnor të Zjedhjeve jo më vonë se 70 ditë para ditës së zgjedhjeve . Partia Lëvizja për Ndryshim me shkronja nistore LN ka depozituar në Komisionin Gjnor të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për tu rregjistruar si subjekt zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Kërkesa e paraqitur nga partia LN respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1të nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Dokumentacioni i paraqitur nga Partia LN përbëhet si më poshtë:

- Vërtetim i lëshuar nga zyra e regjistrimit të partive politike pranë Gjyaktës të rrethit Gjygjësorë Tiranë nëpërmjet të cilës vërtetohet se kjo parti rezulton e rregjistruar në dokumentacionin e kësaj zyre,
- Emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të parties,
- Emri zyrtar dhe shkronjat nistore dhe adresën e partisë,
- Specimeni i vulës së partisë,
- Emri, mbiemri dhe adresa e financierit të partisë,
- Emri, mbiemri dhe adresa e personit përgjegjës për komunikimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,
- Deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në taktikat e blerjes së votave,

*Zbardhi materialin e incizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

marrjes së financimeve apo përfitime të kundraligjshme, vecanërisht ato që vinë nga aktivitete kriminale si dhe përkushtimin për te konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet,

- Deklaratën e partisë model 01 /1 per hapjen e llogarisë së posaçme nga ana e kryetarit të partisë.

Nga verifikimi përkatës konstatohet se kërkesa dhe dokumentacioni është në përputhje me nenin 64 të Kodit Zgjedhor dhe 92/2 pika 2 e këtij kodi.

E paraqesim për miratim dhe shqyrtim projekt vendimin e mësipërm dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Mirë, faleminderit.

Atëhere bazuar në nenin 19 pika 1 shkronja n, nenin 64 dhe 92 /2 pika 2 të ligjit 10019 datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, vendos:

- 1.Të regjistrojë si subjekt zgjedhor Partinë Lëvizja për Ndryshim për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.27

*Zbardhi materialin e incizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:17

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”


PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Iirjan** **CELIBASHI** **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi** **KQZ** **Y.Merkaj, E.Jorgaqi, O.Peto**
- **Parti** **Politike**
- **Vëzhgues:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës tjetër!

Z.Y.Merkaj: Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, me shkronja nistore “PLDSh”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z.Myslym Murrizi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021. Kërkesa e paraqitur nga kjo parti, respekton afatin kohor parashikuar në nenet 64 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Dokumentacioni i paraqitur nga Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, përbëhet nga: Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*


emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë; emri zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë; specimeni i vulës së partisë; dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë; emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në; deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të paligjshme, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet; deklaratën e partisë Model 01/1 për hapjen e llogarisë së posaçme nga kryetari i partisë. Pas verifikimit konstatohet se dokumentacioni dhe kërkesa plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 64, 92 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit, atëherë meqenëse dokumentacioni i paraqitur nga Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare është në përputhje me kërkesat e ligjit, bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, dhe 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, vendos :

- 1.Të regjistrojë “Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare”, me Kryetar z.Myslym Murrizi, me shkronjat nistore “P.D.Sh”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.28

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:17

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Ora e Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi, O.Peto**
- **Parti Politike**
- **Vëzhgues:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës së Partisë Ora e Shqipërisë!

Z.Y.Merkaj: Partia Ora e Shqipërisë, me shkronja nistore “POSh”, nëpërmjet Kryetarit të saj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Kërkesa e paraqitur nga Partia Ora e Shqipërisë si dhe dokumentacioni përkatës, është në përputhje me nenin 64 dhe 92/2, pika 2 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Dhe sipas administratës duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni për shqyrtim e miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin e depozituar nga kjo parti, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

Z.I.Celibashi: Atëherë, meqenëse dhe dokumentacioni i Partisë Ora e Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, vendos:

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë”, me Kryetar z.Zef Shtjefni, me shkronjat nistore “P.O.Sh.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.29

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:20

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”


PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Illirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi, O.Peto**
- **Parti Politike**
- **Vëzhgues:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike e Shqipërisë!

Z.Y.Merkaj: Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë, me shkronja nistore “AD”, nëpërmjet Kryetarit të saj zotit Eduart Abazi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Kërkesa e paraqitur nga kjo parti si dhe dokumentacioni përkatës, është në përputhje me parashikimet e nenit 64 dhe 92/2, pika 2 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni për shqyrtim e miratim projektvendimin dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

Z.I.Celibashi: Atëherë, meqenëse dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia Aleanca Demokratike Shqiptare është në përputhje me kërkesat e “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, vendos:

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, “Partinë Aleanca Demokratike Shqiptare”, me Kryetar z.Eduart Abazi, me shkronjat nistore AD.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.30

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:21

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Bindja Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja,O.Peto

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z.Y.Merkaj: Po, Partia Bindja Demokratike me shkronjat nistore BD nëpërmjet kryetarit të saj zotit Astrit Patozi ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Kërkesa e paraqitur nga Partia Bindja Demokratike si dhe dokumentat shoqërues janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni për shtyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin e paraqitur, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Meqënëse kërkesa e Partisë Bindja Demokratike është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor respektivisht nenin 19, pika 1, shkronja n edhe pika 2 si dhe nenin 64 dhe neni 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor vendos:

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

- 1.Të regjistrojë si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 Partia Bindja Demokratike me kryetar zotin Astrit Patozi dhe me shkronja nistore BD.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe regjistrohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimit dhe Sanksioneve.

Vendim nr.31

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetërorë i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:22

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Lëvizja e Legalitetit për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, O.Peto

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z.Y.Merkaj: Partia Lëvizja e Legalitetit me shkronja nistore PLL nëpërmjet kryetari të saj zotit Shpëtim Axhami ka depozituar Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Pas verifikimit të dokumentacionit konstatohet se ky dokumentacion dhe kërkesa është në përputhje me nenin 64 dhe 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Meqënëse kërkesa e Partia Lëvizja e Legalitetit është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor respektivisht nenin 19, pika 1, shkronja n edhe pika 2 si dhe nenin 64 dhe neni 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor vendos:

**Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetërorë i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

- 1.Të regjistrojë si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 Partia Lëvizja e Legalitetit me kryetar zotin Shpëtim Axhami dhe me shkronja nistore PLL.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe regjistrohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimit dhe Sanksioneve.

Vendim nr.32

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetërorë i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:23

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitete për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- KQZ:
- Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Stafi KQZ: Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, O.Peto

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z.Y.Merkaj: Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet me shkronja nistore PDIU nëpërmjet kryetari të saj zotit Shpëtim Idrizi ka depozituar Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Pas verifikimit të dokumentacionit konstatohet se ky dokumentacion dhe kërkesa është në përputhje me nenin 64 dhe 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Meqënëse kërkesa e Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor respektivisht nenin 19, pika 1,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetërorë i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

shkronja n edhe pika 2 si dhe nenin 64 dhe neni 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor vendos:

- 1.Të regjistrojë si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet me kryetar zotin Shpëtim Idrizi dhe me shkronja nistore PDIU.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe regjistrohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimit dhe Sanksioneve.

Vendim nr.33

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:24

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Balli Kombëtar për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilijan CELIBASHI** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, O.Peto

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z.Y.Merkaj: Partia Balli Kombëtar me shkronja nistore PBK nëpërmjet kryetari të saj zotit Adriatik Alimadhi ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Pas verifikimit të dokumentacionit konstatohet se ky dokumentacion dhe kërkesa është në përputhje me nenin 64 dhe 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Meqënëse kërkesa e Partia Balli Kombëtar është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor respektivisht nenin 19, pika 1, shkronja n edhe pika 2 si dhe nenin 64 dhe neni 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor vendos:

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

- 1.Të regjistrojë si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 Partia Balli Kombëtar me kryetar zotin Adriatik Alimadhi dhe me shkronja nistore PBK.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe regjistrohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimit dhe Sanksioneve.

Vendim nr.34

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:26

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Emigracioni Shqiptar për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi, O.Peto**
- **Parti Politike**
- **Vëzhgues:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z.Y.Merkaj: Partia Emigracioni Shqiptar, me shkronja nistore “PESh”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z.Kostaq Papa, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021. Pas verifikimeve përkatëse, administrata e KQZ-së konstaton se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia Emigracioni Shqiptar, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 dhe 92/2, pika 2, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

Z.I.Celibashi: Po, atëherë meqenëse dokumentacioni i Partisë së Emigracionit Shqiptar është në përputhje me kërkesat e ligjit, bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, vendos :

- 1.Të regjistrojë si subjekt zgjedhor “Partia Emigracioni Shqiptar”, me Kryetar z. Kostaq Papa, me shkronjat nistore “P.E.Sh”, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.35

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:26

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Reformave Demokratike e Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”


PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Illirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi, O.Peto**
- **Parti Politike**
- **Vëzhgues:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër

Z.Y.Merkaj: Partia Reforma Demokratike e Shqipërisë, me shkronja nistore “PRDSh”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z.Krenar Rryçi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021. Kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga kjo parti, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 dhe 92/2, pika 2, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin përkatës të paraqitur nga kjo parti, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

Z.I.Celibashi: Po, atëherë, meqenëse dokumentacioni lidhur me kërkesën e Partisë Reformave Demokratike e Shqipërisë për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 është në përputhje me kërkesat e e Kodit Zgjedhor, bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja "n", e 2, në nenin 64 dhe 92/2, pika 2, të "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", vendos :


1.Të regjistrojë si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 "Partia Reformave Demokratike e Shqipërisë", me Kryetar z. Krenar Rryçi, me shkronjat nistore "P.R.D.SH".

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.36

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:28

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z.Pal Shkambi, i propozuar nga zgjedhësit në qarkun Shkodër, për zgjedhjet në Kuvendin të datës 25 Prill 2021”

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Illirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi, O.Peto**
- **Parti Politike**
- **Vëzhgues:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër

Z.Y.Merkaj: Me Dekretin nr.11700 të Presidentit të Republikës është caktuar data 25 Prill 2021. Referuar nenit 69, pika 3, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se “Për paraqitjen e një kandidati nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar të organizojnë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve komiteti nismëtar regjistrohet në KQZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit”. Bazuar në përcaktimet e nenit 69, “Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet në Kuvend”. Komiteti nismëtar i përbërë nga, z.Shuk Pepçi, z.Nikollë Lulashi, z.Fran

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

Kodra, z.Agustin Pllumbaj, z.Kolë Qukaj, z.Gjin Mhillaj, z.Valentin Sheu, z.Ndojë Sukaj, z.Vuksan Kulla, z.Ndue Binoshaj, zj.Orieta Shkambi, i janë drejtuar KQZ-së me kërkesë për regjistrimin e komitetit nismëtar të formuar prej tyre. Kërkesa e paraqitur prej tyre është administruar në KQZ në datën 27.01.2021. Kërkuesit e kanë paraqitur kërkesën e tyre duke depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre në të, si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës kopjet e dokumenteve të identifikimit. Kërkuesit me vullnetin e tyre të lirë kanë vendosur krijimin e komitetit nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin z.Pal Shkambi. Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, rezulton se, 11 anëtarët komiteti nismëtar rezultojnë si zgjedhës në zonën zgjedhore qarku Shkodër. Pas verifikimeve përkatëse, administrata e KQZ-së konstaton se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur prej këtyre zgjedhësve, respekton kriterin e afatin e përcaktuar në nenin 69 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, gjithashtu respekton edhe pikën 3 të nenit 69 që parashikon së grupi nismëtar krijohet nga jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore që do paraqesin kandidatin. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe dokumentacionin e paraqitur nga komiteti nismëtar, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Po, atëherë, meqenëse dokumentacioni i paraqitur nga komiteti nismëtar për të paraqitur zotin Pal Shkambi si kandidat të propozuar nga zgjedhësit është në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor, bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, si dhe neni 69, pika 3, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, vendos :

1. Regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z.Pal Shkambi, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.37

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

05.02.2021

Ora 11:31

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z.Plarent Aleksi, i propozuar nga zgjedhësit në qarkun Berat, për zgjedhjet në Kuvendin të datës 25 Prill 2021”

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi, O.Peto**
- **Parti Politike:**
- **Vëzhgues:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër

Z.Y.Merkaj: Bazuar në nenin 69, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, kemi një komitet tjetër nismëtar të përbërë nga, z.Elvis Kondakçi, zj.Aleksandra Kondakçi, z.Armelind Kondakçi, zj.Antoneta Rustemi, z.Eneo Lybesha, z.Ilirjan Pilo, zj.Anila Kondakçi, zj.Olimbi Kondakçi, zj.Hasime Kondakçi, të cilët i janë drejtuar KQZ-së me kërkesë për regjistrimin e komitetit nismëtar të formuar prej tyre. Kërkuesit e kanë paraqitur kërkesën e tyre duke depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre, si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës kopjet e dokumenteve të identifikimit. Kërkuesit me vullnetin e tyre të lirë kanë vendosur krijimin e komitetit nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.05.02.2021*

për kandidatin z.Plarent Aleks. Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, rezulton se, 9 anëtarët e komitetit nismëtar rezultojnë si zgjedhës në zonën zgjedhore qarku Berat. Pas verifikimeve konstatohet se dokumentacioni është në përputhje me nenin 69, pika 3 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se komiteti nismëtar krijohet nga jo më pak se 9 anëtarë. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimine mësipërm dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Po, atëherë, meqenëse dokumentacioni i paraqitur nga komiteti nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Plarent Aleks si kandidat të propozuar nga zgjedhësit, për zonën zgjedhore të Qarkut Berat është në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor, bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, dhe pika 2, si dhe neni 69, pika 3, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, vendos :

1.Regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z.Plarent Aleks, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Berat, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Faleminderit, pikë tjetër në rendin e ditës nuk kemi, kështu që seanca mbyllet.

Vendimi nr.38

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

